

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Princi Harry rikthehet në shtëpi pas 6 vitesh: Është fantastike të jem sërish në tokën britanike! Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/princi-harry-rikthehet-ne-shtepi-pas-6-vitesh-eshte-fantastike-te-jem-serish-ne-token-britanike/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 15:31:08 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 15:19:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f3b838eedf889a72c2723853f071aee62ee2f37e2d697a5cb5445ff9ef27a541
TEKSTI	4631dec8fd31db47d3406302c7fd261930d476dbccdeac53e4bb4a355d09be1d
PAMJA	89e40d3f9e67aa8a904b6d9a2ec5adbd1a2976770098b8850f3f6bca012f1196

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8be19707f103eae259b183fe0da15b4ded970631491354e5d4497369d505db27
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0334a22cab892da6eda5613cc640e69aa8a23a21585bae5896651df887e79535
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8be19707f103eae259b183fe0da15b4ded970631491354e5d4497369d505db27>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Bota

Princi Harry rikthehet në shtëpi pas 6 vitesh: Është fantastike të jem sërish në tokën britanike!



Ervin Nikolla

26 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

© Netflix

Prici Harry ka folur për rikthimin e tij në Mbretërinë e Bashkuar pas gjashtë vitesh jetë në Kaliforni, duke thënë se ndihet “shumë mirë” që është sërish në tokën britanike. Në një intervistë për rrjetin kanadez CTV, Duka i Sussex tha se qëndrimi i tij në Britani “ka qenë i mrekullueshëm”, ndërsa u shpreh i kënaqur që fëmijët e tij janë të lumtur në shkollë.



“Ka qenë shumë mirë. Është fantastike të kthehem në tokën britanike. Fëmijët janë të lumtur në shkollë dhe kjo më jep mundësinë të përqendrohem vërtet në Lojërat Invictus në Birmingham në korrik të vitit të ardhshëm”, tha Harry.

Princi Harry dhe **Meghan Markle** u tërhoqën nga rolet e tyre si anëtarë të lartë të familjes mbretërore në vitin 2020 dhe nisën një jetë të re në Shtetet e Bashkuara. Muajin e kaluar, ata u kthyen në Britani, ndërsa familja thuhet se është vendosur në një rezidencë private në zonën e Cotswolds, jashtë Londrës. Fëmijët e çiftit, Archie, 7 vjeç, dhe Lilibet, 5 vjeçe, u detyruan të ndërrojnë shkollë vetëm pak ditë pasi nisën mësimin, për shkak të shqetësimeve për sigurinë gjatë udhëtimit. Sipas raportimeve, ekipi privat i sigurisë së Sussex-ëve kishte ngritur shqetësime për distancën dhe trafikun e shtuar gjatë rrugës drejt shkollës.

Ndërkohë, Meghan Markle ka kufizuar ndjeshëm paraqitjet e saj publike, ndërsa Harry ka vijuar me një sërë angazhimesh, kryesisht të lidhura me punën e tij për Lojërat Invictus. Javën e kaluar, ai vizitoi një shkollë në Birmingham, ku prezantoi një program edukativ të frymëzuar nga Lojërat. Gjatë vizitës, Harry mori pjesë në një lojë me nxënësit dhe në një mesim shkencor mbi projektimin e gjymtyrëve protetikë. Lojërat Invictus do të zhvillohen në Birmingham nga 10 deri më 17 korrik të vitit të ardhshëm.

Harry foli për CTV pas një hedhjeje me parashutë në Toronto, të cilën e realizoi për të nderuar një premtim ndaj një veterani 102-vjeçar të Luftës së Dytë Botërore, si dhe për të rritur ndërgjegjësimin për bamirësitë ushtarake. I pyetur për arsyet e rikthimit të familjes në Britani, Duka i Sussex tha se kishte “shumë arsye”, por nuk dha detaje të tjera.

LAJME TË NGJASHME



Mijëra qytetarë në Madrid protestojnë për krizën e emigrantëve në Ceuta, kërkojnë zgjedhje të parakohshme!

1 MIN



Polonia i ofron stimuj financiarë SHBA-ve/Bisedime për bazën ushtarake!

1.5 MIN



Trump e paralajmëroi Xi-në, të mos e mbështesë Iranin!

1 MIN



A mund të bëhet Bjellorusia furnizuese kryesore e SHBA-ve me potas?

4 MIN



Fitoi jackpot 223 milionë euro, ish-gruaja i bëhet 'makth'/Ja se çfarë i kërkon!

2.5 MIN

MË TË LEXUARAT



Punë e pagëndrueshme dhe pension i hershëm, studimi zbulon lidhjen me plakjen e trurit!



Gjiganti italian i modës Gucci nxjerr në treg atlete “Made in China”!



Cindy Crawford përjetoi vite të vështira për djalin e saj?



Madonna tërheq vëmendjen me fotografi provokuese, pozon me reçipeta transparente?



“The Real Rooneys” përballet me kritika? A është jeta e Wayne dhe Coleen Rooney vërtet kaq autentike?



“Send Nudes”? Sydney Sweeney shfaqet provokuese në një tjetër fushatë?



A kaloni shumë kohë ulur? Ja çfarë mund të ndodhë nëse ecni çdo gjysmë ore!



A ju ndodh të shihni të njëjtën ëndërr vazhdimisht? Çfarë mund të fshihet pas saj?



Tanimë gjërat kanë ndryshuar/Shenjat e zodiakut që më në fund po fillojnë një kapitull të ri të jetës së tyre!




Nations League, sonte SHQIPERI vs. BJELLORUSI/Ekskluzivisht në DigitAlb!

EDITORI SUGJERON



Tronditëse/Fëmijët në moshë të vogël po marrin gjithnjë e më shumë ilaçe për obezitetin!



Hormoni i stresit mund të ndikojë edhe te kujtimet? Çfarë ndodh në tru kur qëndrojmë gjatë nën presion?



A mjaftojnë 7 orë gjumë? Ja çfarë duhet të dini!



A mund të ndikojë ushqimi në ëndrra? Këto ushqime mund të lidhen me makthe?



A kanë ëndrrat kuptim? Çfarë thonë teoritë shkencore?



Sa kalori digjen gjatë vërtetë seksit?!



"Zemra ndalet për gjysmë ore..."/ Prof. Dr. Altin Veshti zbulon çfarë ndodh gjatë operacionit: Pacientët kanë frikë!



Melatonin apo L-Theanine?! Ja cili suplement mund të ndihmojë më shumë me gjumin...



Të njëjtat vargje të përsëriten gjithë ditën? Ja pse një këngë mund të të "ngecë" në kokë...



Një ilaç i ri për kancerin e pankreasit mund t'u japë pacientëve më shumë kohë!

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

Kontakti
Marketing
Frekuencat
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for tabnav widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.